

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CONSTRUCTIVA” SH.P.K

Në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit” dhe të ligjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare dhe prodhuese në Republikën e Shqipërisë, me vullnetin e tyre të lire, shtetasit:

Brusi Vora, l biri I Luanit , i datëlindjes 26.10.1993, lindur në Shijak , Nr ID J31026008B

Erdi Shahini l biri I Fatmirit, l datelindjes 03.09.1987, lindur dhe banuese në Tiranë, Nr ID I70903055R

Ani Vora, l biri I Nexhmi, l datelindjes 23.08.1993 lindur në Durrës, NR ID J30823014G

Shaban Hajri, l biri I NdriÇim, i datelindjes 05.06.1990, lindur në Durrës, identifikuar me numër personal J00605017A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, kanë vendosur krijimin e Akt Themelimit dhe Statutin e shoqërisë “CONSTRUCTIVA” SH.P.K

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CONSTRUCTIVA” SH.P.K



KREU I

THEMELIMI I SHOQËRISE ,EMRI I SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

THEMELIMI I SHOQËRISË

1.1 Ortaket themelues jane shtetasit shqiptare, Brusi Vora, Erdi Shahini, Ani Vora, Shaban Hajri te cilet kane vendosur te themeloje Shoqërinë me Përgjegjësi te Kufizuar te emertuar “ **Constructiva** ” SH.P.K

Shoqëria ,e formuar me iniciativën e ortakeve themelues ,konsiderohet e themeluar ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe me Statutin e saj,pjese e ketij akti.

Shoqëria I nënshtrohet legjislacionit Shqiptar ,ndersa degët qe mund te krijohen jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë do t’i nënshtrohen legjislacionit te vendit ku do te kete qendren dega.Degët e shoqërise do te ushtrojne veprimtarine ne emer dhe per llogari te kesaj shoqerie dhe Brenda kopetencave qe do tu jenë dhënë me aktet e krijimit apo me akte te tjera te veçanta.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

2.1 Themelohet Shoqëria, shoqëri e së drejtës shqiptare ne momentin e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar ,duke u paisur me numrin tatimor te identifikimit NUIS, me emrin si me poshte shenuar:

“ CONSTRUCTIVA ” SH.P.K

NENI 3

SELIA PHE FORMA LIGJORE E SHOQERISE

3.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Durres, Lagja Nr.15,Spitalle,Njesia Strukturore DR_UB_EI_457/11.**



3.2 Ortaket mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra perfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

3.3 Forma ligjore e shoqërisë është "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "Shpk". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

NENI 4

KOHËZGJATJA

4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

NENI 5

OBJEKTI I SHOQËRISE

5.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është, për të gjitha llojet e importit dhe eksportit të materialeve të ndërtimit, Prodhim i hekurit dhe nënprodukteve të hekurit, transport, projekttimeve dhe punimeve të ndërtimit:

1. Në fushën e ndërtimeve civile, industriale, turistike, bujqësore, etj. Kompletimi dhe instalimet e nevojshme për to, rikonstruksione godina civile ekonomike, veshje fasadash, ndërtim rrugësh, vepra arti rrugore, punime hidroteknike, ujësjellës dhe kanalizime, punime restaurimi, prodhim elementesh parafabrikate të beton armë, mirmbajtje dhe zhvillim dekorativ, punime gjeotezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeotezike, rivellime topografike etj. Import eksport me pakicë dhe shumicë të mallrave të ndryshme të lendeve të para të ndërtimit dhe prodhimeve, ngritje pike servisi të automjeteve dhe lavazhe automjeteve. 2. Shërbime të konsulentëve inxhinierikë në fushën e mbikqyrjes së shtatimit të punimeve, kolaudim të zbatimit të punimeve. Përveç kësaj shoqëria mund të ushtrojë dhe aktivitete si: pastrimi mbeturinave të inerteve urbane dhe të plehrave të qytetit, prodhim dhe tregtim fidanesh frutash dhe pyjor etj.

5.2 Për më tepër shoqëria mund të veprojë si agjent/ndërmjetës për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontrakttojë palë të treta për kryerjen e një pjesë apo të të gjitha shërbimeve të mësipërme.

5.3 Gjithashtu. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit të shërbimeve, konsulentëve



tregtimin e mallrave te ndryshem.

5.4 Per te arritur objektin e saj, Shoqeria mund te realizoje drejtperdrejte apo ne mënyrë të terthorte cdo lloj pjesemarrje ne shoqeri të tjera shiptare apo te huaja, si edhe të hyje ne marredhenie kontraktore, bashkepunimi ose ortakerie me persona te trete, private ose publike, vendas ose te huaj. Shoqeria mund te ushtroje cfaredolloj aktiviteti tjeter te papercaktuar ne kete akt, te cfaredolloj natyre qe nuk eshte ne kundërshtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi pa asnjekufizim.

KREU II

KAPITALI I SHOQERISE TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 6

KAPITALI I SHOQERISE

6.1 Kapitali i Shoqerise eshte 100,000 (njqind mije) Lek, i perbere nga kontributi i ortakeve.kuota te cilat mund te tjetersohen pjeserisht ose teresisht ,ku perfituesi i pare per blerjen e kuotave eshte njeri nga ortakët.

Ndarja do te jete si me poshte vijon:


- **Z. Brusi Vora** me 10% te pjesemarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,eshte zoteruesi i nje kuote me vlere 10.000 leke
- **Z.Erdi Shahini** me 40% te pjesemarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,eshte zoteruesi i nje kuote me vlere 40.000 leke
- **Z.Ani Vora** me 25% te pjesemarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,eshte zoteruesi i nje kuote me vlere 25.000 leke
- **Z.Shaban Hajri** me 25% te pjesemarrjes te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise,eshte zoteruesi i nje kuote me vlere 25:000 leke

NENI 7

TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT TEK TE TRETET

7.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, dhurim, trashegimi, ose me çdo menyre tjeter te parashikuar nga legjislacioni perkates ne fuqi ne R.Sh.

7.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojë ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat. Mosrespektimi i kesaj dispozite e ben te palvlefshem transferimin e kuotave.



7.3 Vlera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortakët me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortakët nuk bien dakort.

KREU III

ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET NENI 8

ORTAKET

8.1 Ortaket e shoqerise jane:

Brusi Vora, I biri I Luanit ,i datëlindjes 26.10.1993,lindur ne Shijak ,Nr ID J31026008B

Erdi Shahini I biri I Fatmirit,I datelindjes 03.09.1987,lindur dhe banuese ne Tirane, Nr ID I70903055R

Ani Vora,I biri I Nexhmi,I datelindjes 23.08.1993 lindur ne Durres,NR ID J30823014G

Shaban Hajri, I biri I NdriÇim,i datelindjes 05.06.1990,lindur ne Durres, identifikuar me numër personal J00605017A

NENI 9 ORGANET E SHOQERISE

9.1 Organet e Shoqerise Jane:

- a) Asambleja e Pergjithshme;
- b) Administratoret.

Neni 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithe ortakët .



10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithe ortakeve Jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 11

ASAMBLEJA E ZAKONSHME

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri Jo me vone Se 30 dite me te njehtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 12

ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.

12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njehtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 13

Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi



13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

Neni 14

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e anetareve te Keshillit te Administrimit dhe caktimin e shperblimit te tij!tyre;
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
- e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
- j) shperndarjen e fitimeve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese;
- m) çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kerkesa per kredi bankare dhe / ose nenshkrimet te faturave, garanci ose garanci ne favor të paleve të treta.

NENI 15

FINANCIMI I SHOQERISE

Four handwritten signatures in blue ink are visible at the bottom of the page. The first signature is a stylized 'P'. The second signature is 'Shahini'. The third signature is a stylized 'K'. The fourth signature is a stylized 'H'.

15.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e metejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shperblim (interesa) apo pa shperblim, në varsi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen keto fonde.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

NENI 16

ADMINISTRIMI I SHOQËRISE

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator

☑ Ani Vora, l biri i Nexhmi, l datelindjes 23.08.1993 lindur në Durres me NR ID J30823014G, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar., i cili emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë. Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikqyr dhe zbaton politiken e biznesit të Shoqërisë;
- b) përfaqëson Shoqërinë;
- c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
- d) Pasi përgatiten nga ekspertët e kontraktuar, nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e tatimeve ja paraqet Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabel të çertifikuar dhe raporti i llogaritave publike të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;



16.2 Administratori mund te ndermarre apo te kerkoi kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshnie per arritjen e objektit të Shoqerise pervec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve te tjera te Shoqerise.

16.3. Përvec sa me sipër,

a. Administratori ka gjithashtu te gjitha të drejtat e administrimit të zakonshem dhe të jashtezakonshem, të gjitha kompetencat dhe të drejtat per të vepruar në marredhenie me të tretet në emer të shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim të kompetencave që ligji ua njeh shprehimisht ortakeve.

b. Administratori, bazuar në nje vendim te asamblese së ortakeve, mund te emeroje, drejtoje, perfaqesues me prokure dhe të mandatuar te pergjithshem per veprime të caktuara ose kategori veprimesh.

c. Administratori i shoqerise nuk mund te shese dhe/ose bleje pasuri te paluajtshme në emër dhe per llogari të shoqerise, pa marrë me pare miratimin paraprak me shkrim te asamblese se ortakeve. *

NENI 17

SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

17.1 Shperblimi i administratonit te shoqerise do te percaktohet nga Ortaket.

KREU V

KONTROLI KONTABEL I SHOQERISE VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 18

KONTROLI KONTABEL

18.1 Kontrolli i jashtem kontabel i Shoqerise kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do te emerojne një apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 19

VITI FINANCIAR

19.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Si perjashtim, viti i pare financiar i veprimtanise se Shoqerise fillon nga data e regjistrimit te saj në Regjistnin Tregtar te Qendres Kombetare të Biznesit.

NENI 20



BILANCI DHE REZERVAT

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratoret marrin masat e nevojshme per hartimin e bilancit te aktivitetit per vitin financiar të mbyllur ne menyre qe ortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të percaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividendeve qe rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga keto shuma jane zbritur humbjet e mundshme të viteve të meparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

KREU VI

PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 21

PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

21.1 Ne rastin e likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (te ndryshuar).

NENI 22

NJOFTIMET

22.1 Te gjitha njoftimet kerkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bejne personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen te kryera ne mënyre te rregullt kur u dergohen në adresat e deklaruarat prej tyre prane Administratoreve te Shoqerise. Per kete qellim, brenda 5 (pese) diteve nga regjistrimi efektiv i cdo ortaku (si l tille) ne regjistrin tregtar, ky i fundit eshte i detyruar ti komunikojë administratorit adresen postare dhe adresen postare elektronike ku deshiron te marre njoftimet. Brenda te njejtit afat i komunikon administratorit te shoqerise adresen e re, kur adresa ndryshon, ne te kundert njoftimi konsiderohet si i kryer rregullisht.

22.2 Njoftimet zyrtare te komunikimeve me ane të mjeteve elektronike vertetohen sipas Legjislacionit per nenshkrimin elektronik dhe dergohen ne adresat elektronike të deklaruarat prej tyre.

22.3 Ne rastin kur një kuote zoterohet nga me shume se nje person te gjitha njoftimet do ti drejtohen perfaqesuesit te bashkezoteruesve te kuotes.

KREU VII

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

NENI 23

LIGJI I ZBATUESHEM

23.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj në perputhje të plote me kete Akt themelim dhe Statutin e shoqerise. si dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar në kete Akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar perkates ne fuqi.



23.2 Ky Akt hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaket themelues, firmoset si me poshte prej tyre.

Ortaket e Shoqerise

Brusi Vora

Brusi Vora 

Erdi Shahini

Erdi Shahini
Shahini 

Ani Vora

ANI VORA 

Shaban Hajri

Shaban Hajri


Durres me 08.09.2025